

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues gjyqtari Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsen Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve E. K. e D. E. që të dy nga Prizreni për shkak të vëprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 paragrafi2 të KP-së, sipas aktakuzës së PTH në Prizren PP/I.nr.42/17 të datës 28.04.2017, gjatë seancës së shqyrimit fillestar duke vendosur mbi marrëveshjen e pranimit të fajësisë PP/42 të datës 10.07.2017 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Genc Nixha, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av. N. E. si dhe av.A. B., me datë 11.07.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

Të akuzuarit:

E. K. , nga i ati A. dhe e ëma M. , i lindur në fshatin KK Dragash, i lindur me , në Duhël, tani me banim në Prizren në Rrugën “ ” nr. , i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shiqtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

D. B. , nga i ati A. dhe e ëma K. , e vajzërisë K. , i lindur me , në fshatin , tani me banim në Prizren në Rrugën “ ” nr. , i martuar me profesion hotelier, ka të kryer shkollën 'fillore i gjendjes së mesme ekonomike, shiqtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I akuzuari E. K. :

Se më dt. 22.03.2017 rrëth orës 19:20 min. në Prizren, vë në qarkullim si të vërtet paranë e falsifikuar në atë mënyrë që dorëzon pranë Marketit "Lanti-B" në Prizren, me rastin e pagimit të gjësendeve të blera në market dorëzon shumën prej 100 euro, me nr. serik X 18875419217 për të cilën punëtorja së pari dyshon se e njëjta është e falsifikuar por më pas ia kthen kusurin dhe duke pas dyshimin se paraja është e falsifikuar njofton pronarin dhe vërtetohet se e njëjta është e falsifikuar dhe përmes kamerave të cilat kanë qenë të montuara në brendinë e marketit identifikohet i pandehuri dhe lajmërohet policia të cilët vërtetojnë se personi i dyshuar është këtu i pandehuri i njohur për policinë dhe organet e ndjekjes me ç' rast edhe arrestohet ditën e nesërme, ndërsa nga e dëmtuara është marrë paraja e falsifikuar nga ana e policisë.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 të KP-së.

I akuzuari D. B. :

Se me dt.24.03.2017 rrëth orës 14:30 min. në Prizren, vë në qarkullim si të vërtet paranë e falsifikuar në atë mënyrë që me rastin e bastisjes së kryer në lokalini e tij e cila gjendet në rrugën "Jusuf Gërvalla" me kontrollimin paraprak të lokalit si dhe të trupit të tij tek i njëjtë janë gjetur 2 bankënota nga 100euro për të cilat dyshohet se janë të falsifikuara e për të cilat i njëjti deklaron se ia ka dhënë një

kushëri i tij. quajtur A. B. e për të cilën ka ditur se të njëjtat janë të falsifikuar e që më pas të njëjtat janë konfiskuar nga ana e pjesëtarëve të policisë.

Kësot dore ka kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga nenit 302 par.2 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitivit të lartshënuar 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73 si dhe nenit 302 par.2 të KP-së, të akuzuarit i:

GJ Y K O N

1. Të akuzuarin E. K.

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

2. Të akuzuarin D. B.

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve,

Në kuptim të nenit 47 të KP-së, e me pëlqimin të akuzuarve, dënimimi me burgim prej 6 (gjashtë) muajve i shqiptuar ndaj tyre, i zëvendësohet me dënim me gjobë, ashtu që:

- Të akuzuarit E. K. dënimimi i shqiptuar me burgim prej 6 (gjashtë) muajve, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilën shumë i akuzuarit obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

- Të akuzuarit D. B. dënimimi i shqiptuar me burgim prej 6 (gjashtë) muajve, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuarit obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se të akuzuarit nuk munden ose nuk dëshirojnë që ta paguajnë gjobën, atëherë dënimimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do ti llogaritet një ditë burgim.

Në kuptim të nenit 69 par.1 lidhur me nenin 302 par.6 i konfiskohen bankënotat e sekuestruara dhe ate 1 x 100 euro me nr. serik X18875419217 nga i akuzuarit E. K. dhe bankënota 1 x 100 me nr.serik S 33541990069 dhe 1 x 100 euro me nr.serik L22526152198 të sekuestruara nga i akuzuarit D. B.

Obligohen të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës në lartësi prej nga 50 (pesëdhjetë) eurove, krejt këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzën PP.nr.42/17 të datës 28.04.2017, kundër të akuzuarve E. K. e D. B. për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga nenit 302 par.2 të KP-së. Gjatë seancës së shqyrtimit fillestar Prokuroria Themelore në Prizren me datë 10.07.2017 ka parashtruar marrëveshjen për pranimin e fajësisë PP.nr.42/17 të datës 10.07.2017.

Gjykata në pajtim me nenin 247 të KPP-së gjatë shqyrtimit fillestar ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit gjatë seancës ka ngelur në tërësi pranë marrëveshjes së arritur duke shtuar se gjykatës i kemi parashtruar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë duke theksuar se kemi bërë shumë lëshime nga se për këtë lloj të veprës penale parashihen dënimet mjafë të rënda, por duke ditur se këtu të akuzuarit e kanë kuptuar se veprimet e tyre kanë qenë në kundërshtim me ligjin neve edhe ju kemi ofruar marrëveshjen ashtu sikurse është përshkruar dhe gjendet para jush, andaj edhe në këtë drejtë ne propozojmë që marrëveshja të pranohet në tërësi.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. K. av. N. E. ka deklaruar se me të mbrojturin e tij janë pajtuar për të lidhur marrëveshje ku i njëjtë ka pranuar fajësinë dhe të njëjtën e ka nënshkruar sikurse në pikat e saj, si mbrojtës ia ka shpjeguar të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë si dhe vet nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe i njëjtë me vullnet dhe me dëshirën e vet edhe këtë marrëveshje e ka pranuar si të tillë.

I akuzuari E. K. është pajtuar me fjalët të dhënë nga mbrojtësi i tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit D. B. av. A. B. ka deklaruar se pas konsultimeve me të mbrojturin e tij kanë ra në ujdi kanë dhënë pëlqimin për lidhjen-negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. I mbrojturi i tij, i akuzuari D. B. është njoftuar dhe sqaruar çka do të thotë pranimi i fajësisë duke ia sqaruar favoret dhe pasojat e kësaj marrëveshje. Këtë marrëveshje e kanë nënshkruar me vullnet dëshirë pa shtyje, pa presion nën prezencën e prokurorit, andaj mbrojtja i propozon gjykatës që këtë marrëveshje të arritur dhe dënimin e rekomanduar të na aprovojë.

I akuzuari D. B. është pajtuar me fjalët të dhënë nga mbrojtësi i tij.

Gjykata nën kushtet dhe rrëthanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Sa i përket gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar ashtu si është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës në kushtet dhe rrëthanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë kështu që gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari E. K. më dt. 22.03.2017 rreth orës 19:20 min. në Prizren, vënë në qarkullim si të vërtet paranë e falsifikuar në atë mënyrë që dorëzon pranë Marketit "Lanti-B" në Prizren, me rastin e pagimit të gjësendeve të blera në market dorëzon shumën prej 100 euro, me nr. serik X 18875419217 për të cilën punëtorja së pari dzhon se e njëjta është e falsifikuar por më impas ia kthen kusurin dhe duke pas dyshimin se paraja është e falsifikuar njofton pronarin dhe vërtetohet se e njëjta është e falsifikuar dhe përmes kamerave të cilat kanë qenë të montuara në brendinë e martketit identifikohet i pandehuri dhe lajmërohet policia të cilët vërtetojnë se personi i dyshuar është këtu i pandehuri i njohur për policinë dhe organet e ndjekjes me crast edhe arrestohet ditën e nesërme, ndërsa nga e dëmtuara është marrë paraja e falsifikuar nga ana e policisë.

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuari D. B. me dt. 24.03.2017 rreth orës 14:30 min. në Prizren, vënë në qarkullim si të vërtet paran e falsifikuar në atë mënyrë që me rastin e bastisjes së kryer në lokalini e tij e cila gjendet në rrugën "Jusuf Gërvalla" me kontrollimin paraprak të lokalit si dhe të trupit të tij tek i njëjti janë gjetur 2 bankënota nga 100 euro për të cilat dyshohet se janë të falsifikuara e për të cilat i njëjti deklaron se ia ka dhënë një kushëri i tij quajtur A. B. e për të cilën ka ditur se të njëjtat janë të falsifikuar e që më pas të njëjtat janë konfiskuar nga ana e pjesëtarëve të polisë

Pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, si dhe të akuzuarit lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se i akuzuari Xh . P. ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari gjykata ka konstatuar se i akuzuari në asnjë mënyrë nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar ta pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale te rastit konkret të cilat janë paraqitur në aktakuzë të pranuara edhe nga i akuzuari dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrëthanat që parashihen në dispozitat e nenit 253 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës, prandaj edhe ka vendosur që ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Lidhur me dënimin prokurori i shtetit ka qëndruar pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe ka shtuar se pajtohet që gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ti merr parasysh dispozitat për zbutjen e dënimit duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

I akuzuari dhe mbrojtësi i tij lidhur me dënimin kanë deklaruar se qëndrojnë pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Gjkata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të pëershkuar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënit të gjykata ka vlerësuar të gjitha rrëthanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësës së dënit, si rrëthanë posaçërisht lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka vlerësuar rrëthanat personale të akuzuarve dhe atë sa i përket të akuzuarit E . K mori parasysh moshën e tij relativisht të re, gjendjen e tij të varfér ekonomike, se është i pa punë sjelljen e tij të mirë në gjykatë, gjithashtu edhe për të akuzuarin D . B gjykata mori parasyshë faktin se , se është i martuar baba i një fëmiu, se në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt. Kështu që duke mos gjetur rrëthana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në diapositiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcione veprat penale të kryera dhe me rrëthanat personale të cilat i posedon akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450, dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 51/2017 me datë 11.07.2017

Procesmbajtësja
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues
Skender Coçaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.